



E DREJTA CIVILE

Pjesa e II-të

SENDET

(2007/036)

Prizren/Kosovë

E drejta civile (pjesa e II - sendet)

SENDET

Sendet janë objekt i së drejte reale. Sendi është ajo pjesë e natyres materiale, që i plotëson dy kushte: kushti i parë është ai fizik, çka dëshmohet se kjo pjesë duhet t'i nënshtrohet pushtetit të njerezve dhe se dyti është kushti shoqëror, që dëshmohet se kjo pjesë e natyres njekohesisht duhet të jetë edhe mall, dëshmohet të mund të shkëmbehet dhe të dalë në qarkullim ekonomik. Kuptimi i sendit dhe i mallrave nuk është identik. Marksistët theksojnë se puna e njeriut është mall, por sipas të drejte borgjeze nuk është edhe send. Në të drejtën civile send është vetëm malli.

Parimet e së drejtës sendore:

- parimi i absolutitetit
- parimi i numrit të kufizuar të të drejtave sendore
- parimi i publicitetit të të drejtave sendore dhe
- parimi i specialitetit të të drejtave sendore

burimet e së drejtës sendore- në sistemin kontinental: ligji si burim kryesor

- në sistemin anglosaxon: vendimet gjyqësore plus statute law dhe konventat ndërkombëtare.

Ndarja e së drejtës sendore

Sendet e luajtshme dhe të paluajtshme

Sendet janë objekt i marrëdhënies juridiko-sendore. Kjo do të thotë se sendet janë objekt i së drejtës sendore. Në sende të paluajtshme bëjnë pjesë toka dhe të gjitha sendet e lidhura për të ndërsa send i luajtshëm konsiderohet ai send i cili mund të bartet nga një vend në një tjetër pa i ndryshuar esenca.

Sendet në qarkullim dhe jashtë qarkullimit

Akti i bartjes së sendit nga një titullar në tjetrin e kushtëzon ndarjen e sendeve në të qarkullueshme dhe sende jashtë qarkullimit. Aftësia e sendeve që të paraqiten si objekte të të drejtave subjektive dhe si objekte të punës quhet aftësia qarkulluese e sendeve. Sendet që nuk mund të jenë në qarkullim juridik, konsiderohen si të mira të përgjithshme dhe këto nuk mund të jenë objekt i ndonjë të drejte sendore, sepse janë në funksion të plotësimit të nevojave të përbashkëta të njerëzve. Në këtë grup të sendeve bëjnë pjesë: ajri i lire, deti i hapur, lumenjtë etj.

Pasuritë publike në natyrë ekzistojnë disa të mira materiale mbi të cilat nuk lejohet konstituimi I të drejtave pronësore. Të mirat materiale të natyrës që janë në funksion të plotësimit të nevojave të të gjithë personave ndryshe quhen edhe pasuri publike. Këto përbëjnë grupin më të madhe të sendeve jashtë qarkullimit.

Sendet në qarkullim të kufizuar

Në sistemin juridik ku ekziston ekonomia e tregut, qarkullimi I sendeve jo vetëm që duhet të jetë I lirë por kërkohet edhe vënia në qarkullim e sendeve pa kurrfarë kufizimi. Mirëpo kjo nuk është e mundur ngase përveç që kemi sende jashtë qarkullimit ekziston edhe një tërësi sendesh të cilat mund të vihen në qarkullim por në mënyrë shumë të kufizuar. Ky kufizim mund të ketë për qëllim aspektin shëndetësor, sigurinë e shtetit dhe të qytetarëve. Në qarkullim të kufizuar mund të jenë armët, mjetet narkotike, disa barna etj...

Superficies solo cedit

Parimin SSC të cilin e njihte e drejta romake nënkupton faktin se cdo gjë që është e lidhur për toke I takon pronarit të tokës. Në të drejtën romake nuk ekzistonte ndarja e pronësisë në toka dhe ndërtesa. Ky parim ka gjetur vend edhe në të gjitha kodet e shek.XIX dhe legjislacionet e mëvonshme.

Sendet e konsumueshme dhe të pakonsumueshme

Sendet e konsumueshme janë të gjitha ato sende të cilat me një të përdorur konsumohen ose dukshëm I zvogëlohet vlera e tyre. Ndërsa sende të pakonsumueshme janë të gjitha ato sende të cilat nuk harxhohen me një përdorim. Ato kanë për qëllim një përdorim më të gjatë. Sende të konsumueshme janë sendet ushqimore etj. Sende të pakonsumueshme konsiderohen: toka, ndërtesat, që janë njëkohësisht edhe sende të paluajtshme.

Sendet e individualizuara dhe sendet e shquara sipas gjinisë (gjenerike)

Sende të individualizuara konsiderohen ato sende të cilat janë unike në gjininë e tyre, psh vetura unicate. Për dallim nga sendet e individualizuar, sende gjenerike konsiderohen ato sende që përcaktohen sipas llojit dhe sasisë, psh librat e njëjta në shitore.

Sendet e zëvendësueshme dhe sendet e pazëvendësueshme

Send I zëvendësueshëm është ai send në vend të të cilit mund të vij një send tjetër I ngjashëm, me veti të njëjta si dhe me destinim dhe vlerë të njëjtë.

Sende të pazëvendësueshme janë ato sende të cilat nuk mund të zëvendësohen me një send tjetër, psh piktura.

Sendet e pjesëtueshme dhe te papjesëtueshme

Sendet të cilat mund të pjesëtohen në pjesë të llojit të njëjtë pa e humbur vlerën e tyre janë sende të pjesëtueshme. Këtu si kriter merret vlera e sendit, pra aspekti ekonomik jo ai fizik. Kurse sende të papjesëtueshme janë ato sende që nuk mund të ndahen në sende të njëllajta, sepse do ta humbnin cilësinë dhe vlerën e tyre. Kjo ndarje ka rëndësi të bashkëpronësia dhe obligimi me shumë debitorë.

Sendet e thjeshta dhe sendet e përbëra

Në të drejtën sendore send I thjeshtë është ai send që paraqet një tërësi natyrale të një gjinie, psh një copë stofi, guri, shtylla etj. I përbërë është sendi I cili përbëhet nga shumë pjesë të ndryshme, psh., një këmishë.

Sendet kryesore dhe aksesore

Send kryesor konsiderohet ai send I cili për nga natyra dhe qëllimi duket se është me rëndësi më të madhe ekonomike.

Send kryesor konsiderohet ajo pjesë e sendit që përmban në vete karakteristikat e tërë sendit, I cili mund të jetë objekt I ndonjë të drejte sendore. Ndërsa aksesor konsiderohen pjesët përbërëse pa të cilat sendi kryesor do të pushonte të ishte me të vërtetë ai që ka qenë.

Sendet tubë (Universitates rerum)

Në disa raste ekziston mundësia që sendet të paraqiten si tubë sendesh, resp., universitates rerum. Tubë sendesh kemi atëherë kur përbëhen nga sende të llojit të njëjtë, resp., sende të llojeve të ndryshme, por në një vend të caktuar. Kur bëhet fjalë për tubë sendesh të llojit të njëjtë, si shembull merren librat në bibliotekë. Etj.

Sendet trupore dhe jotrupore

Ndarja në sende trupore (res corporales) dhe sendet jotrupore (res incorporales), ekziston që nga e drejta romake. Në legjislacionet ku nuk konsiderohen sende vetëm pjesë trupore të natyrës, ekziston mundësia e njohjes edhe e sendeve jotrupore të cilat sipas rregullit numërohen të gjitha të drejtat pasurore përveç të drejtës së pronësisë, pra të drejtat sendore mbi sendin e huaj. (Vedrish)

Frytet (fructus)

Frytet gjithashtu janë send aksesor dhe deri në ndarjen nga sendi kryesor janë pronësi e pronarit të sendit kryesor. Frytet janë sende që sendi kryesor I jep periodikisht por, që janë të destinuara për ndarje.

Frytet janë të gjitha produktet natyrore dhe juridike që krijohen nga vlerat pasurore, ose nga përdorimi faktik dhe juridik I saj. Frytet ndahen në fryte natyrore dhe civile.

Frytet natyrore janë sende të cilat I jep sendi, pa e humbur substancën e vet, këtu bëjnë pjesë: frutet e pemëve, bimëve, produktet e bagëtive etj. Frytet civile janë rezultat I ndonjë pune juridike dhe zakonisht janë në para, por lejohet mundësia që këto të jepen edhe në natyrë.

Sendi I përbërë sipas destinimit ekonomik

Sendi I përbërë sipas destinimit ekonomik ekziston atëherë kur kemi pjesë të vecanta fizike të cilat kanë rëndësi ekonomike, vetëm atëherë kur janë të bashkuara.

Paraja dhe letrat me vlerë si send

Në të drejtën sendore, paraja konsiderohet send I luajtshëm I zëvendësueshëm, I konsumueshëm, I pjestueshëm dhe sipas gjinisë send I shquar. Paraja është e zëvendësueshme, jo vetëm për llojin e vet, por me te mund të shkëmbehet edhe cdo send tjetër, qoftë I shquar sipas gjinisë, apo individualisht.

Paraja është mjet, jo vetëm I qarkullimit ekonomik por edhe I atij juridik, sepse ajo është masë vlere e sendeve pa marrë parasysh llojin e tyre. Në të drejtën sendore, edhe letra me vlerë është objekt I së drejtës së pronësisë. Letra me vlerë ka cilësinë e sendit. Letra me vlerë mund të përcaktohet si dokument, si punë juridike por edhe si send. Letra me vlerë është dokument I shkruar që përmban vlerë pasurore.

Posedimi (Possessio)

Posedimi si institut juridik paraqet një gjendje faktike të mbrojtur nga e drejta pozitive (e aplikueshme). Posedimi nuk konsiderohet e drejtë sendore por vetëm pushtet faktik mbi sendin. Posedimi paraqitet si ceshtje e domosdoshme për cdo të drejtë sendore. Mbajtësi I sendit të gjetur, të vjedhur apo të blerë nga jopronari edhe pse sillet si pronar I sendit ai është vetëm një posedues I thjeshtë, pra ai ka vetëm pushtetin faktik mbi sendin por jo edhe ate juridik. Pushteti juridik mbi sendin I takon vetëm pronarit të vërtetë.

Rëndësia e posedimit

Rëndësia e posedimit për të drejtën civile në përgjithësi dhe për të drejtën sendore në vecanti është shumë e madhe. Poseduesi I sendit supozohet se është pronar ose titullar I ndonjë të drejte tjetër sendore.

Objekti I posedimit

Objekt mund të jenë sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, individualisht të përcaktuara. Këtu bëjnë pjesë edhe frytet e shkëputura. Sendi për të qenë objekt I posedimit duhet të dalë në qarkullim juridik, kjo bëhet me punë juridike.

Sendet që janë në përdorim të përgjithshëm nuk mund të jenë objekt I posedimit, psh rrugët, parqet publike etj.

Nëse mbi një send është I mundshëm fitimi I pronësisë ose e drejta e shfrytëzimit është I mundshëm edhe posedimi ndaj tij.

Posedimi I së drejtës

Përvec posedimit të sendeve ekziston edhe posedimi I të drejtave. Kur dikush nuyk ka pushtetin e plotë faktik ndaj sendit por vetem pushtet të atillë që është përmbajtje e ndonjë të drejte sendore tjetër ai ka posedimin e të drejtave. Tek ky lloj posedimi është e drejta që dtth se objekt mund të jetë edhe një e drejtë servituti, e drejta në barrën reale, e drejta e obligacionit, që janë rezultat I ndonjë une juridike.

Posedimi I të drejtave që përmbajnë dy elemente corpusin dhe animusin , quhet posedim I drejtë, I cili gëzon mbrojtje juridike.

Corpusi tek posedimi I të drejtave dtth kryerja faktike e përmbajtjes esenciale të ndonjë të drejte.

Animusi, tek posedimi I të drejtave dtth vullneti që të ushtrohet përmbajtja e ndonjë të drejte, si e drejtë e tij.

Krijimi dhe shuarja e posedimit

Në të drejtën sendore, rëndësi të vecantë paraqet momenti I konstituimit të ndonjë të drejte sendore. Posedimi edhe pse nuk është e drejtë, krijimi saj lidhet për faktin e caktuar.

Posedimi I cili paraqet pushtetin faktik mbi sendin, resp., mbi të drejtën, lind me konstituimin e pushtetit faktik ndaj sendit që është objekt I posedimit.

Fitimi I posedimit

Posedimi mund të fitohet në dy mënyra: në ate origjinere dhe derivative. Fitim origjiner I posedimit dtth fitimi I posedimit pa ose kundër vullnetit të poseduesit të deritanishëm. Në këtë rast fitimi bëhet pa marrë parasysh paraardhësin.

Fitimi derivativ është mënyrë tjetër e fitimit të posedimit dhe dtth se fitimi I posedimit bëhet me vullnetin e poseduesit paraardhës, që nënkupton kalimin e posedimit nga një posedues në poseduesin tjetër. Fitimi derivativ bëhet pra me dorëzimin e sendit dhe dorëzimi I sendit nënkupton konstituimin e posedimit.

Bashkëposedimi ose posedimi I përbashkët

Në të drejtën sendore, ekziston institucioni I bashkëpronësisë, randaj edhe gjendja faktike mund të paraqitet si bashkëposedim. Posedimi I këtillë është I mundëshm tek të gjitha të drejtat që mund të kenë më shumë titullar, psh edhe tek e drejta e pronësisë, servituti, bashkëposedimi, pushtetin faktik të poseduesit e ushtrojnë sipas pjesëve alikuote et. Në rastet tjera kemi të bëjmë me posedimin individual (të një titullari). Përvec bashkëposedimit ekziston edhe posedimi I përbashkët, kur dy e më shumë persona e ushtrojnë pushtetin faktik mbi sendin dhe nuk dihet vëllimi I ushtrimit të pushtetit faktik derisa të ndahet sendi I përbashkët në posedim.

LLOJET E POSEDIMIT

Posedimi I drejtëpërdrejtë dhe posedimi I tëthortë

Posedimi I drejtëpërdrejtë ekziston atëherë kur personi drejtëpërdrejtë ose përmes të autorizuarit, ushtron pushtetin faktik mbi sendin.

Posedimi indirekt, ekziston atëherë kur personi pushtetin faktik mbi sendin e ushtron përmes një personi tjetër, I cili në bazë të frytgëzimit, kontratës mbi pengun, qerasë, shërbimit , e ka sendin në posedim të drejtëpërdrejtë.

Posedimi I ligjshëm apo jo I ligjshëm.

Posedim I ligjshëm është posedimi I cili mbështetet në bazë juridike të vlefshme.

Posedimi I paligjshëm është posedimi I cili nuk mbështetet në ndonjë bazë juridike. Emërtimi I posedimit në të ligjshëm dhe të paligjshëm varet nga ekzistimi respektivisht mosekzistimi I bazës juridike të vlefshme. Kur posedimi e ka bazën e vlefshme, ka mundësi që të bëhet edhe pronar përmes institutit të parashkrimit fitues.

Posedimi I vërtetë dhe jo I vërtetë **Posedimi I vërtetë është ai I cili fitohet me bazë** të rregulltë, me dorëzim të lejueshëm të sendit në pushtet faktik. Posedimi I vërtetë është ai posedim që nuk është fituar me vëllim ose precaris, që dth me forcë, mashtrim ose keqpërdorimin e besimit.

Në rastet kur posedimi bëhet me forcë, mashtrim ose keqpërdorimin e besimit ekziston posedimi jo I vërtetë, pra posedimi I pavërtetë ai që fitohet me dhunë, mashtrim dhe me forcë.

Posedimi me mirëbesim dhe me keqbesim

Posedues me mirëbesim është ai që nuk di apo nga rrethanat e arsyeshme nuk duhet të dinte se sendin që e posedon është I tj. Posedimi është me miëbesim kur poseduesi nuk e ka ditur ose nuk ishte I detyruar ta dinte se posedimi I tij është I paligjshëm, ndërsa posedimi është me keqbesim kur

poseduesi e ka ditur ose duhet ta dinte se posedimi I tij është I paligjshëm, psh pushteti faktik krijohet edhe me vjedhje.

Mbrojtja e posedimit

Mbrojtja e posedimit është një element dallues I posedimit. Mbrojtje juridike gëzon edhe vjedhësi I sendit, I cili ka krijuar pushtetin faktik mbi sendin. Posedimi nuk është e drejtë sendore megjithate posedimi gëzon mbrojtje juridike.

Për mbrojtjen e posedimit ekzistojnë dy padi: padia për pengimin e posedimit dhe padia për kthimin e posedimit. Për mbrojtjen e posedimit ligji lejon paditë për pengim posedim dhe padia për rikthimin e posedimit, ndryshe quhen edhe padi posesore edhe vetëmbrojtja si mjet I mbrojtjes së posedimit.

Shuarja e posedimit

Posedimi është pushtet faktik mbi sendin. Me humbjen e pushtetit faktik mbi sendin humb edhe posedimi. Zhveshja nga pushteti faktik duhet të jetë kundër vullnetit të poseduesit. Posedimi shuhet me shkatërrimin e sendit që është objekt I posedimit, pastaj posedimi shuhet me bartjen e sendit në personin tjetër etj.

E drejta e pronësisë

Pronësia dhe pasuria

Pasuria është tërësi e të drejtave subjektive civile me karakter pasuror që I takojnë një personi. Lëndë e pasurisë janë sendet dhe vlerat ekonomike. E drejta e pronësisë është e drejtë sendore që përmban autorizime më të mëdha lidhur me përdorimin, shfrytëzimin dhe disponimin e një sendi.

Pronësia për nga përmbajtja e vet është e drejtë e pushtetit më të gjerë që I njihet pronarit mbi një send. Autorizimet më të gjera të pronësisë janë e drejta e përdorimit, shfrytëzimit dhe disponimit.

Pronësia si e drejtë sendore bën pjesë në të drejtën subjektive absolute dhe është e rregulluar me dispozita imperative. Përmbajtja e pronësisë mund të ndryshojë ose të kufizohet.

Karakteristikat e pronësisë E drejta e pronësisë cilësohet me disa karakteristika, sic janë uniteti I të drejtës së pronësisë, e drejta lidhet për subjekt të caktuar, pra e drejta e pronësisë është unike edhe kur autorizimet gëzohen nga më shumë subjekte, sepse ato nuk mund ta ndryshojnë përmbajtjen e pronësisë. Karakteristikë tjetër është veprimi plotësisht I lirë për të disponuar me sendin etj.

E drejta fqinjësore Është e drejtë e titullarit të paluajtshmërisë që ta përdorë paluajtshmërinë e fqinjit për ushtrimin e plotë të pushtetit të të drejtës së pronësisë së tij. Kjo e drejtë mund të ekzistojë vetëm midis pronarëve të paluajtshmërive fqinje.

E drejta fqinjësore është rregullator për kufizimin e të drejtës së pronësisë. E drejta e pronësisë edhe pse është e drejtë absolute ajo praëseprapë në disa raste I nënshtrohet kufizimeve të caktuara.

Imisionet

Paraqiten si një kufizues I të drejtës së pronësisë në rastet kur ato duhet të durohen si një e keqe e pashmangshme. Në këtë rast bëhet fjalë për imisionet e lejuara. Imisionet mund të jenë edhe të palejuara, psh lëshimi I tymit, gazit, avullit, zhurmës, ujrat e pista etj, nqs këto e pengojnë pronarin e pasurisë fqinjësore.

E drejta e pronësisë me më shumë subjekte

Bashkëpronësia

Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët nuk janë lloj I vecantë I pronësisë, or formë e ekzistencës bashkërisht të shumë subjekteve të së drejtës së pronësisë mbi sendin.

Bashkëpronësia si institut juridik ekziston kur dy ose më shumë persona kanë të drejtë pronësie mbi një send, secili sipas pjesëmarrjes së vet.

Fitimi I bashkëpronësisë Mund të bëhet në mënyrë të njëjtë sikurse edhe fitimi I pronësisë individuale pra në bazë të punës juridike, vendimit të organit kompetent dhe në bazë të ligjit. Bashkëpronësia mund të krijohet në bazë të kontratës së shitblerjes, ndërrimit, dhurimit etj.

Zgjidhja e bashkëpronësisë Bashkëpronësia është institucion juridik që I nënshtrohet zgjidhjes, kur këtë e kërkojnë bashkëpronarët.

Bashkëpronarët mund të merren vesh që mos të lejohet kërkesa për zgjidhjen e bashkëpronësisë.

Zgjidha e bashkëpronësisë mund të bëhet:

1. me marrëveshjen e bashkëpronarëve dhe
2. në bazë të vendimit gjyqësor të plotëfuqishëm për ndarjen e bashkëpronësisë.

E drejta e pronësisë së përbashkët në pjesë të vecanta të ndërtesës ose pronësia

ETAZHE

Ponësia etazhe është e drejtë pronësore në banesë, lokal afarist ose garazh, si pjesë e vecantë e ndërtesës me të cilën në mënyrë të pandashme janë të lidhura të drejtat e caktuara në pjesët e përbashkëta të ndërtesës dhe në tokën në të cilën është ndërtuar ndërtesa.

Pronësia etazhe e ka prejardhjen nga fjala frenge etage-kat, ose ndryshe quhet pronësi e katit. Pronësia etazhe fitohet sipas rregullave të përgjithshme që vlejnë për fitimin e të drejtës së pronësisë (me ndërtim, me blerje, me ndërrim, trashëgim etj).

E drejta e banimit Është e drejtë e llojit të vecante dhe ajo fitohet vetëm në ndërtesat banuese të pronësisë shoqërore. Me ligj është bërë e mundur që e drejta e banimit të shëndrrohet në të drejtë pronësie me blerjen e banesës ose të shëndrrohet në qiramarrje të lokalit ër banim. Fitimi I të drejtës së banimit është bërë me plotësimin e tri kushteve:

1. Vendimi për ndarjen e banesës
2. kontrata për shfrytëzimin e banesës dhe
3. hyrja në banesë. Nëse nuyk plotësohet njëri nga këto kushte nuk mund të fitohet e drejta e banimit.

Fitimi I pronësisë

E drejta e pronësisë është kategori kushtetuese, se ajo garantohet me kushtetutë andaj edhe fitimi I pronësisë në disa raste parashihet me Kushtetutë, por rregull është se bazat e fitimit të pronësisë rregullohen me ligj. E drejta e pronësisë fitohet në bazë të ligjit, në bazë të punës juridike dhe me trashëgim, si dhe në bazë të vendimit të organit kometent shtetëror.

Fitimi derivativ I pronësisë

Është mënyrë e fitimit të pronësisë, nga titullari I vjetër në titullarin e ri, pra në pronarin e ri. Bartja e pronësisë nga një titullar në tjetrin zakonisht bëhet përmes qarkullimit juridik të të drejtave sendore.

Fitimi origjiner I pronësisë

është mënyrë tjetër e fitimit të pronësisë, që dallon nga fitimi derivativ. Fitimi origjiner ekziston atëherë kur e drejta nuk nxirret nga paraardhësi por në bazë të ndonjë fakti tjetër juridik, zakonisht në bazë të ligjit.

a. okupimi

është titull juridik për fitim e pronësisë në mënyrë origjinere. Okupim dth marrja e sendeve të askujt (res nulus) në posedim me dashje që mbi to të themelohet pronësia.

b. gjetja e sendit të humbur

në bazë të ligjit edhe gjetja e sendit është titull juridik për fitimin e pronësisë në mënyrë origjinere, respektivisht edhe gjetësi I sendit si person fizik mund të bëhet pronar kur I besohet posedimi por pas kalimit të një kohe të caktuar të nevojshme për parashkrim fitues.

c. gjetja e thesarit të fshehur (Thesaurus)

gjetja e thesarit është titull juridik për fitimin e pronësisë në mënyrë origjinere. Është një titull juridik I pranuar në të gjitha kodet civile dhe ligjet tjera që rregullojnë fitimin e pronësisë. Thesar në kuptimin e ligjit konsiderohen paratë, ari, argjendi, gurë të cmueshëm etj që janë fshehur dhe kanë qëndruar për një kohë aq të gjatë sa që pronari nuk mund të dihet.

d. Uzurpimi

Ka ekzistuar në të kaluarën që dtth kur dikush në mënyrë arbitrare e uzurponte pronësinë shtetërore, me qëllim që ta shëndrron në të drejtë të pronësisë. Uzurpimet sot nuk lejohen dhe me uzurpime nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë.

e. komasacioni

nënkupton atë që në siërfaqe të caktuar nga parcelat ekzistuese të vogla dhe jo të rregullta, formohet një masë e përgjithshme (masa e komasacionit) e cila pastaj në formë të numrit më të vogël, por në parcela më të rregullta u ndahet pronarëve të njëjtë.

f. parashkrimi fitues (usucapio)

është titull juridik për fitimin e të drejtës së pronësisë në mënyrë origjinere.

Usucapio është titull I fitimit të pronësisë duke e mbajtur sendin në posedim për kohë të caktuar. Pra me kalimin e kohës poseduesi me mirëbesim bëhet pronar.

f. shpronësimi (Ekspropriimi)

është kalimi I pronës private në atë shtetërore, për interes të përgjithshëm dhe me kompensim. Interesi I përgjithshëm për të cilën mund të bëhet shpronësimi është kuptim mjaftë I gjerë. Mirëpo sipas një dispozite shpronësimi mund të bëhet vecanërisht për ndërtimin e hekurudhave, aeroporteve, urave, rrugëve etj.

Mbrojtja e pronësisë E drejta e pronësisë si e drejtë subjektive e karakterit absolut gëzon mbrojtje juridike. Mbrojtja e pronësisë paraqet një rëndësi të rëndësishme për të cilën nuk është i interesuar vetëm individi, titullari i pronësisë por edhe vetë sistemi juridik.

Paditë për mbrojtjen e pronësisë sipas ndarjes tradicionale janë:

Padia e reivindikimit (actio reivindicatio)- (është padi e pronarit jo posedues kundër poseduesit jo pronar, duke kërkuar nga ky i fundit t'i dorëzojë sendin në posedim.)

Padia publiciane (actio publiciana) – (është padi për kthimin e sendit të cilin e paraqet poseduesi uzurpues i mëparshëm kundër poseduesit aktual).

Padia negatore (actio negatoria)- (me padinë mohuese pronari kërkon mbrojtjen ndaj shqetësimeve që nuk kanë të bëjnë me marrjen e sendit).